

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 10, nenit 15 paragrafi (5), nenit 16 paragrafi (2) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), dhe nenit 28 paragrafi (10) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18, 208/24 dhe 16/2025), dhe duke vepruar sipas njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore nr. 10-39 të datës 03.07.2026, të parashtruar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në seancën e mbajtur më 16.07.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

Për vlerësimin e lejueshmërisë së dhënies së ndihmës shtetërore nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025

1. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Njoftimit për dhënien e planifikuar të ndihmës nr. 10-39 të datës 03.07.2026, të parashtruar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhënës i ndihmës shtetërore dhe Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025, konstatoi se:

1.1 Masa e përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 1 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 nën titullin **Hartimi i dokumentacionit teknik dhe ndërtimi i sistemeve të kanalizimeve dhe sistemeve për kullimin dhe pastrimin e ujërave të zeza në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ujërave në vlerë prej 100.000.000,00 denarë, nuk paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore;

1.2 Masa e përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 2 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 nën titullin **Hartimi i dokumentacionit teknik dhe ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ujërave në vlerë prej 100.000.000,00 denarë, nuk paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore;

1.3 Masa e përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 3 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 **nën titullin Nxitja e studimeve arsimore, kërkimore dhe zhvillimore, programeve dhe projekteve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës në vlerë prej 10.000.000,00 denarë, paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, të cilën si ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 14) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe si skemë e ndihmës në

kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore e jep Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, me ç'rast **dhënia e saj është e lejuar si ndihmë për mbrojtjen e mjedisit jetësor** në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) pika d) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe nenin 15 dhe nenin 22 të Dekretit për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës horizontale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 03/14), **vetëm në rastet kur bëhet fjalë për financimin e studimeve, programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë;**

1.4 Masa e përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 4 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 nën titullin **Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike, edukimin dhe trajnimin në fushën e mjedisit jetësor në vlerë prej 19.000.000,00 denarë, nuk paraqet ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore;

Arsyetim

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të mbështetjes, përkatësisht nëse e njëjta paraqet ose nuk paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Çdo dhënës i ndihmës shtetërore (i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore) është i detyruar, sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, të dorëzojë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës njoftim për çdo plan për dhënien e ndihmës shtetërore të re ose ndryshimin e ndihmës shtetërore ekzistuese, pavarësisht nëse ajo jepet si ndihmë individuale apo si skemë e ndihmës.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor më datë 28.01.2025 dhe më datë 17.02.2025, në përputhje me nenin 13 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore, dorëzoi në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës Njoftim për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore në lidhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025, si dhe plotësim të njoftimit. Gjatë shqyrtimit paraprak të njoftimit të dorëzuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas nenit 14 paragrafi (3) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe nenit 2 paragrafi (5) të Dekretit për mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese, me shkresat e datës 20.02.2025 dhe 03.04.2025 kërkoi nga Ministria informacione dhe sqarime shtesë në lidhje me masën 5 të pjesës IV të Programit për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025 – "Mbështetja e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor". Nga Ministria u kërkua një përshkrim i detajuar i masës, përmbajtjes së saj, kategorive të përdoruesve potencialë, mënyrës së dhënies së mjeteve, si dhe informacion se cilat subjekte mund të realizojnë avantazh ekonomik nga realizimi i saj. Duke marrë parasysh se Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk i dorëzoi informacionet dhe sqarimet shtesë të kërkuara, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, sipas nenit 2 paragrafi (5) të Dekretit të përmendur, konsideroi se njoftimi është tërhequr.

Për shkak të kësaj që u theksua, Komisioni nuk dispononte të dhënat e nevojshme për të kryer vlerësimin e masës në fjalë dhe nuk mori vendim sipas nenit 15 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore në lidhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025. Më datë 11.02.2026 Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dorëzoi në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës Njoftim për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore në lidhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2026.

Në shtojcë të njoftimit u dorëzua edhe Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2026, në të cilin te masa 7 e pjesës IV theksohet se mjetet nga pjesa II paragrafi (1) i Programit shpërndahen edhe për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në përputhje me Programet për investime në mjedisin jetësor për vitin 2023, 2024 dhe 2025, në vlerë të përgjithshme prej 223.050.000,00 denarë. Nga përmbajtja e Programit për investime në mjedisin jetësor për vitin 2026 rezultojnë indikacione se projektet dhe aktivitetet e miratuara në përputhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025 ishin realizuar, përkatësisht se në bazë të saj ishin marrë detyrime financiare dhe/ose ishin dhënë mjete për përdoruesit. Duke pasur parasysh se njoftimi për Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025 konsiderohej i tërhequr, dhe Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës nuk kishte marrë vendim për lejueshmërinë e masave në fjalë, ekzistojnë indikacione se të njëjtat eventualisht ishin realizuar në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Për këtë arsye, në përputhje me nenin 15 paragrafi (4) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe nenin 4 të Dekretit për mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/11), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 10.06.2026 solli Konkluzionin nr. 10-39 për iniciimin e procedurës për vlerësimin e ndihmës shtetërore eventuale të paligjshme në lidhje me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025 të miratuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Për këtë qëllim, KMK në Konkluzionin nr. 10-39 të datës 10.06.2026 obligoi Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të dorëzojë të gjitha të dhënat, informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e ndihmës nga ana e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Për këtë qëllim, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në KMK me shkresën nr. 02-2215/2 të datës 02.07.2026 (Numri ynë 10-39 i datës 03.07.2026) dorëzoi Njoftim në përputhje me Dekretin për mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese.

Në shtojcë të Njoftimit u dorëzuan edhe Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025, Konkursi për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025, Dokumente për zgjedhjen e projekteve, Dokumente për zgjedhjen e projekteve me korrigjim (Konkluzioni, Propozim Vendimi dhe Vendimi me listën e korrigjuar të rangimit), Tabela me projektet dhe statusi i pagesës si dhe Kontratat me përdoruesit e mjeteve të dhëna me Konkursin për vitin 2025.

KMK vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është i rregullt dhe i përmban të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit, përkatësisht se njoftimi i tillë nga forma dhe përmbajtja është në përputhje me

Dekretin për mënyrën dhe procedurën për paraqitjen e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes së ndihmës shtetërore ekzistuese (në tekstin e mëtejme "Dekreti"). KMK gjatë shqyrtimit të njoftimit konstatoi këtë gjendje faktike:

- **Dhënës i ndihmës shtetërore është:** Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- **Përdorues i ndihmës shtetërore është:** Skema e ndihmës – Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025
- **Baza juridike për dhënien e ndihmës shtetërore** paraqet akti juridik në bazë të të cilit jepet ndihma – neni 172 paragrafi (4) i Ligjit për Mjedisin Jetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16, 99/18, 89/22, 171/22 dhe 3/25)

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga ana e dhënësve të ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet plotësimi në mënyrë kumulative i katër kriterëve në vijim:

- masa e tillë të përfshijë shpenzim potencial ose të realizuar të mjeteve shtetërore;
- të jetë selektive;
- të paraqesë avantazh ekonomik për pranuesin dhe
- të ketë ndikim në konkurrencën dhe tregtinë

Prandaj, gjatë shqyrtimit të njoftimit të dorëzuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës konstatoi se masa në pikën 1.3, numri rendor 3 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 nën titullin Nxitja e studimeve arsimore, kërkimore dhe zhvillimore, programeve dhe projekteve për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës në vlerë prej 10.000.000,00 denarë, paraqet **ndihmë shtetërore** për faktin se i plotëson të katër kriteret kumulative. Gjithashtu, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës analizoi edhe kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për realizimin e masës e cila paraqet ndihmë shtetërore.

Gjatë kësaj analize Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës konstatoi se masa e përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 3 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 paraqet ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 14) të Ligjit për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore, pasi ndihma horizontale është ndihmë e cila jepet për kërkim dhe zhvillim, mbrojtjen e mjedisit jetësor, punësim, trajnim, shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik dhe aktivitetet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e dhënë në çfarëdo forme, duke përfshirë edhe formën e kapitalit të rrezikut, qëllimi i së cilës është zgjidhja e problemeve në të gjitha degët industriale, përkatësisht rajonet.

Prandaj, vlerësimin nëse dhënia e ndihmës shtetërore nga pika 1.3, numri rendor 3 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 është e lejuar, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës e kryen në përputhje me dispozitat e Dekretit për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës horizontale.

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës konstatoi se dhënia e masës së përfshirë në pikën 1.3, numri rendor 3 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 paraqet ndihmë shtetërore të lejuar vetëm në rastet kur bëhet fjalë **për financimin e studimeve, programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme të lidhura me përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në përputhje me nenin 15 dhe 22 të Dekretit për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës horizontale.**

Masat e përfshira në pjesën pika 1.3, numri rendor 1, 2 dhe 4 i Konkursit për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 nuk paraqesin ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore sepse të njëjtat nuk e cenojnë, e as nuk mund ta cenojnë konkurrencën përmes mundësimit të avantazhit ekonomik për një ndërmarje të caktuar e cila nuk do të ishte e mundur pa ndihmën shtetërore të dhënë ose përmes favorizimit të prodhimit të mallrave të caktuara ose ofrimit të shërbimeve të caktuara. Rrjedhimisht, masat e theksuara nuk e plotësojnë përkufizimin për ndihmën shtetërore të përcaktuar në nenin 5 paragrafi (1) të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës këto masa dhe aktivitete që ndërmerren nga ana e shtetit janë të karakterit të përgjithshëm dhe janë në drejtim të përmirësimit të kushteve në përgjithësi në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Shpërndarja e mjeteve nga Programi për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025 kryhet përmes një konkursi publik të cilin e shpall dhe e zbaton Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Konkursi për shpërndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera nga fusha e mjedisit jetësor për vitin 2025 është në përputhje me nenin 174 të Ligjit për Mjedisin Jetësor, si dhe me Programin për investime në mjedisin jetësor për vitin 2025.

Për shkak të të theksuarave më lart, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për inicimin e një kontesti administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore. Padia nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, përveç në rast kur KMK-ja do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur dhënia e së cilës nuk është e lejuar.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ